



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.3 mars 2019

Index:

Aktivitete	2
Aktivitete	3
Ligjërimit i hapur	4
KMD në media	5

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, ROBERT GAJDA PREZANTOI NË KUVEND RAPORTIN VJETOR TË KMD



Me datë 12 mars, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda prezantoi në Komisionin parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, raportin e veprimtarisë për 2018 dhe gjendjen e Diskriminimit në vend. Komisioneri Gajda bëri një përmbledhje të rezultateve dhe sfidat që ka hasur institucioni.

Në zbatim të nenit 26, të Ligjit Nr 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku përcaktohet se “Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e Komisionerit dhe të zyrës”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përgatitur dhe paraqet përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2018”.

Vlerësimet dhe rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2017”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që e nxit diskriminimin. Gjithashtu, Manuali i monitorimit vjetor dhe periodik i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përmes Vendimit Nr. 134/2018, ka shërbyer për hartimin e këtij Raporti Vjetor të KMD, si institucion i pavarur i krijuar me ligj, në kuadër të kontrollit parlamentar.

Raporti vjetor i KMD 2018 gjendet i plotë në: www.kmd.al

“Standarteve të përshtatshmërisë fizike dhe informacionit në institucionet e sistemit të drejtësisë për personat me aftësi të kufizuar”



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në tryezën e rrumbullakët mbi prezantimin e “Standarteve të përshtatshmërisë fizike dhe informacionit që duhet të garantohet në institucionet e sistemit të drejtësisë për personat me aftësi të kufizuar”, të organizuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ADRF.

Komisioneri Gajda falenderoi ADRF për angazhimin e plotë për të ndërgjegjësuar dhe advokuar për zbatimin e VKM Nr. 1074, datë 23.12.2015 dhe Ligji Nr. 107/2014, për aksesin në të Drejta të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Gjatë fjalës së tij, Komisioneri Gajda u ndal jo

vetëm tek pengesat infrastrukturore publike dhe të transportit publik që janë të dukshme dhe të prekshme, por edhe për pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion, ku “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëllor si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka krijuar një njësi të posacme për monitorimit të planit Kombëtar të veprimit PAK nga zyra e KMD.



KMD Fush Krujë, në panairin e 4 shoqatave që shërbejnë për personat me aftësi të kufizuar



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda ishte i ftuar në gjimnazin "Shote Gjallica", në Fushë Krujë për aktivitetin gjithpërfshirës, me pjesëmarrjen e 4 shoqatave që ofrojnë shërbime në fushën e aftësisë së kufizuar dhe gjimnazistëve.

Eventi #TëGjithëSëBashkuMundëmiMëShumë përfshinte një aktivitet sportiv dhe panair me produkte që shoqatat Caritas, Ndiemo Jetën, Shoqata e aftësimin për Jetën dhe Shoqata e prindërve të fëmijëve autikë, si dhe klientët e tyre prodhojnë në mënyrë artizanale.

Komisioneri Gajda ofroi mbështetje institucionale për të gjitha problematikat e shprehura dhe garantoj përpjekje maksimale për të promovuar nisma të tilla të sukseshme

KMD takim informues me Komunitetin Rom dhe Egjiptian lidhur me të drejtat e komunitetit

Në ditën Ndërkombëtare për Eleminimin e Diskriminimit Racial, pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u zhvillua një takim informues me Komunitetin Rom dhe Egjiptian lidhur me të drejtat e komunitetit, në mënyrë të plotë dhe të barabartë të të drejtave të tyre me natyrë sociale – ekonomike dhe në mënyrë të veçantë në fushën e arsimit, strehimit, punësimit dhe formimit profesional, shëndetësisë, përkrahjes shoqërore, etj. Komisioneri Robert Gajda vlerësoi shumë përfaqësuesit e këtyre komuniteteve si ura lidhëse mes institucioneve dhe qytetarëve! Më pas të gjithë së bashku vizituan qendën tranzitore të emergjencave në Shish-Tufinë, për të inspektuar kushtet dhe dhënë rekomandimet e përshtatshme.



Komisioneri Gajda në seminarin III të KE dhe ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi nenin 22 të kartës Sociale të Evropës



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në seminarin III të organizuar nga Këshilli i Evropës dhe ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të procedurës së parashikuar nga Neni 22 i Kartës Sociale Evropiane mbi "dispozitat e papranuara".

Qëllimi i takimit është shkëmbimi i pikëpamjeve dhe informatave me autoritetet kombëtare mbi dispozitat që ende nuk janë pranuar nga Shqipëria me qëllim të vlerësimit të mundësisë që vendi ynë të pranojë dispozita shtesë. Komisioneri Gajda vlerësoi parimet themelore të Kartës Sociale Evropiane, të ratifikuar nga vendi ynë në vitin 2002, e cila parashikon në pjesën e V-të të saj parimin e Mos Diskriminimit, ku gëzimi i të drejtave do të

sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkakui të tillë si race, ngjyre, seksi, gjuhe, besimi fetar, mendimi politik ose tjetër, prejardhje kombëtare ose origjinë shoqërore, shëndeti, shoqërizimi me një minoritet kombëtar, lindjeje ose statusi tjetër.

Komisioneri Gajda Ligjërimit të Hapur mbi “Legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në UMSH

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda ishte i ftuar sot në Universitetin Mesdhetar për të mbajtur një Ligjërimit të Hapur mbi “Legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këtë aktivitet morën pjesë studentë të Masterit Shkencor, profesorë dhe stafi akademik i Universitetit të cilët shprehën interes për njohjen e këtij legjislacioni.



Në morinë e ankesave të shqyrtuara nga Komisioneri i Mbrojtjes ndaj Diskriminimit, në 2018-ën mbizotërojnë të larguarit nga puna për shkak të bindjeve politike. Raporti vjetor i KMD ishte pjesë e diskutimit në misionin Wake Up në Top Channel, ku komisioneri Gajda bisedoi për të gjitha kategoritë e diskriminuara, duke përfshirë gjithashtu diskriminimin për shkak të arsimimit, aftësive të veçanta dhe ai racor.

Po ashtu, Komisioneri Gajda prezantoi raportin vjetor të KMD në televizionet Ora News dhe pjesë të saj, në Klan Plus.



NUK KA KAUZË QË
JUSTIFKON
ABUZIMIN ME TË
DREJTAT E
NJERIUT

WWW.KMD.AL



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania
Zip Code: 1001
E-mail: info@kmd.al
Tel:
Komisioneri: + 355 4 243 1077
Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1
Zip Code: 4001
Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1
Zip Code: 7001
Tel: + 355 4 243 1078